

Kuvendi i Shqipërisë Miraton Rezolutën “Për vlerësimin e Veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2015”

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-nëntor 2016

Zhvillime të tjera

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës
- Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së zhvilloi takimin e fundvitit me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrura dhe të mediave
- Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive merr pjesë në festën e fundvitit të Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve
- Takim i nivelit të lartë mbi ndikimet e *Solvency II* dhe mjedisit aktual ekonomik, në strategjitë mbikëqyrëse në Evropën Lindore, Qendrore dhe Juglindore
- Takimi i 12-të i iniciativës për mbikëqyrjen e sigurimeve për vendet e Evropës Juglindore, Qendrore e Lindore
- Seminar për standardet ndërkombëtare të raportimit financiar-krahasimi me kërkesat e Bazel-it

Edukimi i Konsumatorit

- “Eksplorimi i Horizonteve të Reja” - Fjala e Z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (*European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA*)
(Pjesa e dytë)

Lajme Ndërkombëtare

- Greqi
- Hungari
- Poloni
- Serbi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Kuvendi i Shqipërisë Miraton Rezolutën “Për vlerësimin e Veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2015”

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën e mbajtur më 15 dhjetor 2016, miratoi rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2015”.

Kjo rezolutë vjen pas paraqitjes nga Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, më 18 korrik 2016, në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, të Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2015”.

Tekstin e plotë të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë e lexoni në linkun poshtëshënuar:

<http://www.amf.gov.al/files/File/rezoluta-amf-2015-2016.pdf>

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-nëntor 2016

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-nëntor 2016 kapën vlerën mbi 13.38 miliardë lekë, ose 7.85% më shumë se gjatë periudhës janar-nëntor 2015. Gjatë periudhës janar-nëntor 2016, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 996,556 me një rritje prej 1.71% krahasuar me periudhën janar-nëntor 2015.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 21.02% në krahasim me periudhën janar-nëntor 2015. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me mbi 2.39 miliardë lekë, apo 63.46% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 8.69% gjatë periudhës janar-nëntor 2016, krahasuar kjo me periudhën janar-nëntor 2015.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 8.31 miliardë lekë gjatë periudhës janar-nëntor 2016, duke shënuar

○ ○ ○
Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-nëntor 2016 kapën vlerën mbi 13.38 miliardë lekë, ose 7.85% më shumë se gjatë periudhës janar-nëntor 2015.

○ ○ ○

—○○○—
Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 62.33% të tregut të sigurimeve.
—○○○—

një rritje prej 11.48% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 62.33% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 11.54% të tregut të Jo-Jetës;
- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 14.56% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 6.94% krahasuar me periudhën janar-nëntor të vitit 2015. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 58.70% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-nëntor 2016

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) nënshkroi më datë 23 dhjetor 2016, një marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës. Në nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, AMF u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Znj. Enkeleda Shehi, ndërsa Fakulteti i Ekonomisë nga Zv. Dekani Z. Alban Korbi.

Kjo marrëveshje synon zhvillimin e bashkëpunimit dhe partneritetit dypalësh në kuadër të shkëmbimit të informacionit, kërkimit shkencor, përmirësimit dhe pasurimit të përmbajtjes së programeve të studimit, praktikave studentore dhe përgatitjes sa më cilësore dhe profesionale të studentëve.

Në fjalën përshëndetëse, Znj. Shehi theksoi bashkëpunimin e mirë që ekziston mes dy institucioneve, vlerësoi mbështetjen dhe ndihmën e dhënë nga Dekani i Fakultetit Prof. Dr. Dhori Kule për finalizimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe pasqyroi fushat e mundshme të bashkëpunimit.

Në kuadër të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, në ambientet e këtij fakulteti organizoi aktivitetin, “Dita Shqiptare e Sigurimeve”. Kjo është një nismë e re e Autoritetit për edukimin e brezit të ri lidhur me tregjet nën mbikëqyrje. Në një leksion të hapur me temë “AMF Mbikëqyr dhe Rregullon”, Znj. Enkeleda Shehi prezantoi për studentët rolin e AMF-së si mbikëqyrës dhe rregullator i tregjeve financiare jobankare dhe misionin e tij lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve, sigurimin e respektimit të ligjit dhe nxitjen e transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Në leksionin e mbajtur Znj. Shehi bëri një paraqitje të detajuar të tregut shqiptar të sigurimeve duke paraqitur treguesit kryesorë financiarë të këtij tregu, si dhe sfidat me të cilat përballet AMF.

Në përfundim të leksionit Znj. Shehi u shpreh e gatshme t'i përgjigjej pyetjeve të studentëve.

Gjithashtu në ambientet e Fakultetit Ekonomik qëndroi e hapur një stendë informuese për veprimtarinë e Autoritetit dhe tregjeve nën mbikëqyrje.

Znj. Enkeleda Shehi prezantoi për studentët rolin e AMF-së si mbikëqyrës dhe rregullator i tregjeve financiare jobankare dhe misionin e tij lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve, sigurimin e respektimit të ligjit dhe nxitjen e transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, zhvilloi takimin e fundvitit me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrura dhe të mediave

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, zhvilloi më datë 22 dhjetor 2016 takimin e fundvitit, me drejtues të shoqërive të mbikëqyrura nga AMF, që veprojnë në tregun e sigurimeve, të fondeve të pensioneve vullnetare, letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve, si dhe me përfaqësues të medias.

Znj. Shehi në fjalën e saj vlerësoi punën e bërë gjatë vitit 2016 nga shoqëritë e sigurimeve, fondeve të pensioneve dhe fondeve të investimeve, si në drejtim të rritjes së këtyre tregjeve, ashtu edhe në drejtim të përmirësimit të standardeve dhe parimeve të mirëqeverisjes.

Znj. Shehi vuri theksin në sfidat dhe projektet e vitit 2017 për t'i shërbyer rritjes dhe qëndrueshmërisë në tregjet financiare. Rëndësi i kushtoi në fjalën e saj, edhe nevojës në punën e përbashkët, për edukimin e konsumatorit dhe publikut në përgjithësi, në drejtim të njohjes së tregjeve financiare, të kuptimit të riskut që i shoqëron investimet në këto tregje, në drejtim të shpjegimit të mundësive që ofrohen për të qenë pjesëmarrës dhe investitor në një fond investimi, për të qenë i siguar dhe transferuar riskun që shoqëron veprimtarinë, jetën apo pronën, apo për të përfituar një pension më të mirë nesër.

Znj. Shehi theksoi se AMF krahas prezencës në media, po kryen aktivitete konkrete në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, për një edukim financiar të brezit të ri.

Znj. Shehi falenderoi median për pasqyrimin në vijimësi të çështjeve të tregjeve financiare dhe aktiviteteve të AMF-së dhe kërkoi thellimin e bashkëpunimit për të gjetur më shumë hapësira në media, për t'i shërbyer më shumë edukimit të konsumatorit, si një element shumë i rëndësishëm për t'i mirëinformuar dhe orientuar ata sa më drejt.

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive merr pjesë në festën e fundvitit të Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, mori pjesë më datë 13 dhjetor 2016 në takimin përmbyllës të fundvitit me përfaqësues të Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve.

Znj. Shehi vuri theksin në sfidat dhe projektet e vitit 2017 për t'i shërbyer rritjes dhe qëndrueshmërisë në tregjet financiare. Rëndësi i kushtoi në fjalën e saj, edhe nevojës në punën e përbashkët, për edukimin e konsumatorit.

Në fjalën e rastit Znj. Shehi përgëzoi organizatorët për fillimin e veprimtarisë së Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve. Duke bërë një pasqyrë të situatës së përgjithshme për tregun e sigurimit të Jetës, tregun e fondeve të pensioneve dhe tregun e fondeve të investimeve, Znj. Shehi vlerësoi arritjet e deritanishme dhe paraqiti sfidat e zhvillimit të këtyre tregjeve për vitin 2017. Znj. Shehi evidentoi si rritjen sasiore të treguesve të këtyre tregjeve, ashtu edhe përmirësimet ligjore dhe rregullative në funksion të mbikëqyrjes efikase dhe zbatimit të standardeve dhe parimeve të mirëqeverisjes.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve të rëndësishme si Ministria e Financave, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe përfaqësues të Shoqërive të sigurimit të Jetës, të tregut të fondeve të pensioneve dhe fondeve të investimeve.

Takim i nivelit të lartë mbi ndikimet e *Solvency II* dhe mjedisit aktual ekonomik, në strategjitë mbikëqyrëse në Evropën Lindore, Qendrore dhe Juglindore

Autoriteti Austriak i Tregut Financiar (*Financial Market Authority, FMA*) zhvilloi në datat 19-20 dhjetor 2016, në Vjenë, Austri, takimin e nivelit të lartë mbi ndikimet e *Solvency II* dhe mjedisit aktual ekonomik, tek strategjitë mbikëqyrëse në Evropën Lindore, Qendrore dhe Juglindore. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua në këtë takim të nivelit të lartë, nga Znj. Enkeleda Shehi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv.

Diskutimet u fokusuan në:

- Ndikimin dhe efektet e zbatimit në praktikë të *Solvency II* dhe sfidat kryesore mbikëqyrëse në mjedisin e tanishëm ekonomik;
- Rregulloren e cila solli një ndryshim shumë të madh në industrinë e sigurimeve në muajt e fundit që nga dita që u miratua;
- Sfidat kryesore mbikëqyrëse në mjedisin e tanishëm ekonomik;
- Përvojat e para nga aplikimi praktik i këtij regjimi të ri në vendet e BE-së, si dhe;
- Hapat e planifikuara në drejtim të zbatimit të *Solvency II* për vendet jo anëtare të BE-së.

Gjithashtu, pjesëmarrësit në takim diskutuan dhe mbi rolin e EIOPA-s lidhur me shqyrtimin e *Solvency II*, për strategjitë mbikëqyrëse në Evropën Lindore, Qendrore dhe Juglindore, si dhe përpilimin e një strategjie për t'u përballur me rreziqet dhe sfidat e reja ekonomike dhe ligjore që ka sjellë aplikimi i *Solvency II* në tregjet evropiane.

Në këtë takim u diskutua dhe për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, e cila përbën një sfidë të madhe me prezantimin e *Solvency II*.

Pjesëmarrësit në takim diskutuan dhe mbi rolin e EIOPA-s lidhur me shqyrtimin e aftësisë paguese të *Solvency II*, për strategjitë mbikëqyrëse në Evropën Lindore, Qendrore dhe Juglindore, si dhe përpilimin e një strategjie për t'u përballur me rreziqet dhe sfidat e reja ekonomike dhe ligjore që ka sjellë aplikimi i *Solvency II* në tregjet evropiane.

Takimi i 12-të i iniciativës për mbikëqyrjen e sigurimeve për vendet e Evropës Juglindore, Qendrore e Lindore

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë zhvilloi në datat 5-6 dhjetor 2016, në Bled, Slloveni, takimin e 12-të të iniciativës për mbikëqyrjen e sigurimeve për vendet e Evropës Juglindore, Qendrore dhe Lindore.

Takimi ishte organizuar në katër sesione:

- Sesioni i parë konsistoi në prezantimin e përfaqësuesve të vendeve pjesëmarrëse në këtë takim, si dhe parashtrimin e rendit të ditës. Tematika e këtij sesiioni kishte të bënte me veçoritë në vlerësimin dhe ndikimin e sjelljes së personave fizikë që janë në krye të institucioneve financiare, dhe a ndikojnë te këta persona borxhet dhe procedurat e falimentit, si dhe rreziqet e lidhura me këto borxhe në mbarëvajtjen e kompanisë.
- Sesioni i dytë u dominua nga tematika në lidhje me mbikëqyrjen në veprimtaritë ndërkufitare në përgjithësi, tendencat e aktiviteteve ndërkufitare, si dhe pasojat e falimentimit të një operatori ndërkufitar me theks të veçantë në skemat e garantimit.
- Sesioni i tretë dhe i katërt pati më tepër një bashkëbisedim ndërmjet pjesëmarrësve rreth përvojave personale dhe institucionale në lidhje me vlerësimin e anëtarëve të bordit dhe të aksionarëve, si dhe shkëmbimin e informacionit me autoritete të tjera mbikëqyrëse.

Seminar për standardet ndërkombëtare të raportimit financiar- krahasimi me kërkesat e Bazel

Iniciativa Edukative Mbikëqyrëse Evropiane (ESE) zhvilloi në datat 30 nëntor-2 dhjetor 2016, në Vjenë, Austri, seminarin për standardet ndërkombëtare të raportimit financiar me temë SNFR përkundrejt kërkesave të Bazel-it (*IFRS vs. Basel requirements for banks*).

Pjesëmarrës në këtë seminar ishin përfaqësues nga mbikëqyrësit e vendeve të ndryshme të Evropës, si: Austri, Francë, Gjermani, Itali, Suedi, Finlandë, Britani e Madhe.

Temat kryesore që u diskutuan në seminar lidheshin me:

1. Ngjashmëritë bankare dhe ndryshimet midis SNRF dhe kërkesave rregullatore të Bazel:
 - Objekti i SNRF;
 - Objektivat e kërkesave të Bazel-it;
 - Ngjashmëritë dhe ndryshimet.

Një nga tematikat e takimit kishte të bënte me veçoritë në vlerësimin dhe ndikimin e sjelljes së personave fizikë që janë në krye të institucioneve financiare, dhe a ndikojnë tek këta persona borxhet dhe procedurat e falimentit, si dhe rreziqet e lidhura me këto borxhe në mbarëvajtjen e kompanisë.

2. Kërkesat rregullatore të Bazel-it:

- Risqet që mbulohen;
- Koncepti i peshës së risqeve të aktiveve;
- Humbjet e parashikuara dhe ato të paparashikuara;
- Procesi mbikëqyrës i rishikimit;
- Kërkesat e likuiditetit.

3. Kërkesat e raportimit;

4. SNRF me ndikim në burimet e kapitalit;

5. SNK 39 si standard i rëndësishëm me ndikim të madh në bilancet e bankave dhe ndryshimet e parashikuara sipas SNRF 9;

6. Kapitali përkundrejt detyrimeve;

7. Konceptet e zhvlerësimit dhe aplikimit të parametrave sipas Bazel-it për vlerësimin e vlerës së drejtë;

8. Qëllimi i konsolidimit;

9. Seksioni i fundit përmbante pika përmbledhëse për diskutim midis pjesëmarrësve.

—○○○—
Duke reflektuar vizionin dhe strategjinë e re të EIOPA-s konferenca u fokusua në “Eksplorimin e horizonteve të reja”.
—○○○—

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Eksplorimi i Horizonteve të Reja

Fjala e Z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA) mbajtur në Konferencën e 6-të Vjetore në Frankfurt, 18 tetor 2016. Duke reflektuar vizionin dhe strategjinë e re të EIOPA-s konferenca u fokusua në “Eksplorimin e horizonteve të reja” nëpërmjet tre paneleve. Tematikat kryesore të fjalës së mbajtur nga Z. Bernardino lidheshin me katër çështje: (i) metoda gjithëpërfshirëse e EIOPA-s për konvergencën në mbikëqyrje (supervisory convergence); (ii) zhvillimi i produkteve personale të pensionit në Evropë (Pan-European Personal Pension Product, PEPP) në kuadrin e Bashkimit të Tregjeve të Kapitalit; (iii) prioritetet e axhendës së EIOPA-s për mbrojtjen e konsumatorit e lidhur me zbatimin e direktivës Insurance Distribution Directive (IDD) në procesin e dixhitalizimit; (iv) hapat e mëtejshëm në kuadrin rregullator dhe sfidat në vazhdim.

Pjesa e dytë (marrë me shkurtime)

<https://eiopa.europa.eu/Publications/Speeches%20and%20presentations/2016-10-18%20EIOPA%20Annual%20Conference.pdf>

Zhvillimi i Produkteve Personale Mbarëevropiane të Pensionit në kuadër të bashkimit të Tregjeve të Kapitalit

Një nga sfidat kryesore për vendet e Bashkimit Evropian është garantimi i pensioneve të sigurta, adekuate dhe të qëndrueshme për qytetarët. Ekziston një konsensus i gjerë ku të dyja llojet e pensioneve private si ato profesionale ashtu dhe ato personale mund të luajnë një rol të rëndësishëm në diversifikimin e burimeve të të ardhurave të pensionit. Kuadri i ndryshimeve demografike dhe të punës, si edhe mjedisi me norma të ulëta të interesit, përbëjnë sfida specifike edhe për regjimet private.

Njëkohësisht, është evidente se tregu i brendshëm i Bashkimit Evropian ndodhet larg shfrytëzimit të potencialit të plotë, sidomos në fushën e kursimeve afatgjata për pension.

Ekziston një fragmentizim i produkteve në dispozicion të konsumatorëve, nga depozitat e deri tek sigurimi kompleks dhe i kushtueshëm i jetës dhe fondet e përbashkëta (*mutual funds*), ku disa prej tyre nuk janë realisht produkte të kursimeve të pensionit. Rregullat e mbrojtjes së konsumatorit gjithashtu variojnë sipas shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Ky fragmentizim është një pengesë serioze për bizneset ndërkufitare, rrit kostot, ul kthimet mesatare të kursimeve dhe së fundmi dobëson besimin e konsumatorëve në sigurimin e pensioneve private.

Në muajin shkurt të këtij viti, EIOPA paraqiti tek Komisioni Evropian rekomandimin teknik final mbi Produktin Personal mbarëevropian (*Pan-European Personal Pension Product, PEPP*), një produkt i kursimeve personale i sigurtë, transparent dhe me kosto efektive.

Në këndvështrimin tonë PEPP mund të jetë katalizatori për fitimet efektive nëpërmjet ekonomive të shkallës dhe oportuniteteve të diversifikimit të rrezikut, por edhe të konkurrencës dhe inovacionit në përfitim të konsumatorëve.

Ne propozuam një numër standartesh dhe tipare fleksibël për PEPP:

- Dhënie e informacionit të standartizuar bazuar në dokumentacionin kyç mbi paketën e produkteve të investimeve për investuesit e vegjël dhe produkteve të sigurimit (*Packaged Retail and Insurance-based Investment Products, the PRIIP*);
- Zgjedhje të investimeve të kufizuara standarde, me një opsion investimi “të paracaktuar”, ku strategjia e investimit merr në konsideratë edhe lidhjen midis akumulimit dhe pagesave;
- Limite fleksibël dhe të rregulluara të kostove dhe komisioneve;
- Garanci biometrike dhe financiare fleksibël.

Ekziston një fragmentizim i produkteve në dispozicion të konsumatorëve, nga depozitat e deri tek sigurimi kompleks dhe i kushtueshëm i jetës dhe fondet e përbashkëta (*mutual funds*), ku disa prej tyre nuk janë realisht produkte të kursimeve të pensionit.

EOIPA është e gatshme të vazhdojë punën për krijimin e PEPP, përkatësisht në projektimin e produkteve pilot. Ne synojmë të eksplorojmë skemat me kontribute individuale të përcaktuara por edhe produktet me përfitime kolektive.

PEPP duhet të ketë një perspektivë afatgjatë në politikën e investimit për të reflektuar më mirë natyrën afatgjatë të kursimeve të pensionit. Ky aspekt mirëpritet nga perspektiva makro, sepse investitorët afatgjatë nevojiten për t'i siguruar fonde të qëndrueshme ekonomisë së Bashkimit Evropian.

PEPP duhet të parashikojnë periudha minimale të mbajtjes, për të zbutur riskun e falimentimit. Investimet e qëndrueshme të aseteve jolikuide duhet t'i korrespondojnë detyrimeve me një profil jolikuid.

Pas kryerjes së analizës arritëm në përfundimin se PEPP është një mjet i fuqishëm për të mbyllur hendekun në kursimet e pensionit në Evropë. Ky përfundim është mbështetur nga një pjesë e konsiderueshme e grupeve të interesit të cilët iu përgjigjën konsultimit publik.

PEPP mund të jetë një nga rezultatet e prekshme të zhvillimit të bashkimit të tregjeve të kapitalit dhe në përfitim të qytetarëve të Bashkimit Evropian. Së bashku ne duhet të bëjmë të pamundurën për të rifituar besimin e qytetarëve evropianë në Bashkimin Evropian dhe në industrinë e shërbimeve financiare.

Evropianët kërkojnë zgjidhje konkrete për problemet e tyre përkatëse, si në rastin e mungesës së kursimeve adekuate të pensionit. Nëpërmjet PEPP-it qytetarët evropianë mund të shohin benefitet e krijimit të një tregu të vetëm kapitalesh.

EOIPA është e gatshme të vazhdojë punën për krijimin e PEPP, përkatësisht në projektimin e produkteve pilot. Ne synojmë të eksplorojmë skemat me kontribute individuale të përcaktuara por edhe produktet me përfitime kolektive. Ndërkohë që skemat me kontribute të përcaktuara mund të projektohen për të përshtatur riskun e investimeve me kohëzgjatjen e kontratës, duke reduktuar kështu rrezikun për anëtarët, zhvillimi i produkteve me përfitime kolektive (*Collective Profit Sharing Products*) mund të lejojë grumbullimin e investimeve (*Pooling*). Këto ofrojnë kthime të investimit të gjithë anëtarët kështu që të gjithë ata do të përfitojnë nga kthimet mesatare afatgjata të fondit dhe mbrohen nga rezultatet tepër negative në situatat e krizave të tregut.

Dizenjimi i produkteve pilot të PEPP duhet të ofrojë kushtet e përshtatshme për të lejuar qytetarët e Bashkimit Evropian të investojnë në një portofol të balancuar që duhet të përfshijë asete të tilla si kapitali, prona, infrastruktura dhe teknologjitë e gjelbra. Kjo do të japë një shans të mirë nëpërmjet masave mbrojtëse të përshtatshme, për të patur një pension që tejkalon inflacionin duke ofruar një standard të denjë jetese.

Nëpërmjet dizenjimit, këto produkte me përfitime kolektive, shmangin ekspozimin ndaj luhatjeve afatshkurtra të tregut dhe trajtimi rregullator në *Solvency II* mund të për afrohet me rreziqet e shkaktuara efektivisht, duke rezultuar ndoshta në kërkesa për kapital më të ulta.

Për të ndërprerë fragmentizimin aktual të tregut dhe për të rritur shërbimet ndërkufitare duhet të sigurohemi se ekzistojnë rregullat e duhura për të arritur mbikëqyrje me cilësi të lartë në të gjithë Bashkimin Evropian.

Së fundi, produktet pilot të PEPP duhet të jenë të dizenuara në një mënyrë të tillë që të sigurojnë standarde më të larta në transparencë, drejtësi, qeverisje dhe menaxhim të riskut.

Në veçanti, transparenca e PEPP ndaj qytetarëve të Bashkimit Evropian mund të përmirësohet në masë të madhe me zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të centralizuar të informacionit nga EIOPA, duke ofruar informacion të përditësuar online lehtësisht të aksesueshëm të kostove, rreziqeve dhe kthimit të të gjitha PEPP të shitura në mbarë Bashkimin Evropian.

Bashkimi i Tregjeve të Kapitalit mund të ketë sukses vetëm nëse jemi të aftë të rifitojmë besimin e qytetarëve të Bashkimit Evropian në tregjet financiare. Në këtë aspekt unë besoj fuqimisht se konvergjenca në mbikëqyrje duhet të jetë një prioritet i nivelit të lartë në bashkimin e tregjeve të kapitalit.

Zbatimi i PEPP duhet të shoqërohet me një evolucion të kompetencave e mjeteve në dispozicion të EIOPA-s. Për të ndërprerë fragmentizimin aktual të tregut dhe për të rritur shërbimet ndërkufitare duhet të sigurohemi se ekzistojnë rregullat e duhura për të arritur mbikëqyrje me cilësi të lartë në të gjithë Bashkimin Evropian. Kjo sjell nevojën për një centralizim të kompetencave dhe mjeteve, si edhe një mandat të qartë për të përforcuar konvergjencën mbikëqyrëse. Ndërsa PEPP projektohet si një produkt personal, unë besoj se të mësuarit prej tij mund të shkojë gjithashtu në dobi të pensioneve profesionale.

Një hap i rëndësishëm më tej do të jetë projektimi i një regjimi të thjeshtë dhe transparent, dytësor për skemat e pensioneve profesionale me kontribute të përcaktuara. Kjo kornizë duhet të jetë në gjendje të përfitojë plotësisht nga potenciali i tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian, duke ofruar një platformë ndërkufitare të cilën kompanitë evropiane mund ta përdorin për të menaxhuar planet e pensionit të punonjësve të tyre, për të zvogëluar kostot, për të mbështetur financimet afatgjata të ekonomisë së Bashkimit Evropian dhe së fundmi të japin pensione më të mira.

EIOPA do të zhvillojë idetë e para mbi komponentët e kësaj kornize e do të planifikojë zgjidhjet e mundshme të skemës, të cilat do të zbusin rreziqet e anëtarëve, që vijnë nga kalimi drejt skemave me kontribute të përcaktuara.

Greqi

www.xprimm.com

Banka Kombëtare e Greqisë synon të marrë oferta për shitjen e kompanisë së sigurimeve “*Ethniki Insurance*” brenda tremujorit të parë të vitit 2017. Sipas planit të ristrukturimit të hartuar nga Grupi për këtë shoqëri, shitja e saj mund të kryhet brenda gjysmës së parë të vitit të ardhshëm, por burime brenda bankës thonë se procesi i shitjes mund të fillojë që në janar.

Sipas gazetës së përditshme *Kathimerini*, tregu po studiohet për të parë interesin e investitorëve dhe numri i investitorëve të huaj të interesuar ka arritur në 10. E përditshmja raporton se ato përfshijnë sigurues gjermanë si “*German Insurer Allianz*”, grupin financiar kinez “*Fosun*”, fondin e investimeve “*Apollo*”, sikurse edhe grupin kanadez “*Fairfax*” i cili është aksionari kryesor tek “*Eurolife ERB*” pas shitjes së fundit që u bë nga grupi “*Eurobank*”.

Sipas të dhënave nga tremujori i parë i këtij viti, vlerësimi i “*Ethniki Insurance*” ka rezultuar në një shifër që arrin nga 800 milionë deri në 1 miliardë euro, por kjo nuk përbën një çmim fillestar për ofertat e blerjes.

“*Ethniki Insurance*” është një shoqëri që po tërheq investitorë të huaj, pasi ajo ka rreth 18% të tregut grek të sigurimeve dhe volumi i primeve arrin mbi 440 milionë euro.

Hungari

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto të siguruesve hungarezë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016 kapën shifrën prej 2.16 miliardë euro apo 4.6% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Faktori që ndikoi në këtë rritje ishte segmenti i produkteve të Jo-Jetës, kryesisht si rezultat i rritjes me dy shifra të sigurimit të detyrueshëm motorik, MTPL. Zhvillimi i tregut në tremujorin e tretë pati të njëjtin trend si në tremujorët paraardhës.

Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jetës u ulën me 1.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar duke kapur shifrën prej 1.05 miliardë euro. Ulja erdhi kryesisht si rezultat i rënies prej 16.5% në primet e realizuara nga produktet e Jetës të lidhura me fondet e investimit (*Unit-Linked Products*), i cili përbën edhe segmentin me peshën më të lartë në portofolin e tregut. Megjithatë duhet marrë në konsideratë që të dhënat për vitin 2015 dhe 2016 nuk janë plotësisht të krahasueshme si rezultat i standardeve të reja të raportimit të vendosura nga Banka Qendrore e Hungarisë në përputhje me kërkesat e *Solvency II*.

Sigurimi i Jo-Jetës pati një trend pozitiv si në linjën e sigurimit të pronës ashtu edhe në atë të sigurimit motorik. Linjat e sigurimit ndaj shëndetit dhe aksidenteve pësuan një rënie të primit të shkruar bruto, rënie kjo që vazhdon trendin e tremujorëve paraardhës.

Trendi në rritje i primeve të shkruara bruto në sigurimin e pronës u përmirësua me një rritje të primeve të shkruara bruto prej 6.5% duke arritur vlerën prej 425.4 milionë euro. Edhe klasat e sigurimit motorik shënuan një trend të lartë me një rritje të primeve të shkruara bruto prej 27% apo 502.5 milionë euro. Megjithatë linja e sigurimit MTPL pati rritjen më të lartë prej rreth 39%, e ndikuar kjo nga rritja e shitjes së makinave dhe tarifave të MTPL.

Edhe dëmet e paguara u rritën në mënyrë të konsiderueshme si në sigurimin motorik ashtu edhe atë të pronës. Kështu dëmet e paguara kapën një total prej 1.32 miliardë euro apo 3.77% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, ndërsa rritja e pagesave të dëmeve për këto dy linja ishte respektivisht 13% dhe 20%.

Poloni www.xprimm.com

Trendi zbritës, nga i cili u karakterizua tregu polak i sigurimeve, vijoi edhe në tremujorin e tretë me një rënie tjetër të primeve të shkruara bruto prej 2%, duke arritur shifrën prej 9.44 miliardë euro. Faktori që shkaktoi këtë trend zbritës ishte sërish segmenti i sigurimit të Jetës, vlen të përmendet gjithashtu që edhe zhvlerësimi i lehtë i valutës vendase luajti një rol në këtë trend.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me rreth 16% duke kapur shifrën prej 4.13 miliardë euro. Produktet e Jetës të lidhura me fondet e investimit (*Unit-linked products*) shënuan rënien më të lartë duke humbur rreth 27% të vëllimit të primeve të shkruara bruto krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2015. Mjedisi i pafavorshëm i investimit duket të jetë edhe shkaktari kryesor për trendin negativ të shënuar në shitjet e sigurimit të Jetës.

Linjat e sigurimit të Jo-Jetës gjeneruan prime të shkruara bruto prej 5.3 miliardë euro. Linjat e sigurimit motorik patën një rritje të lartë, e nxitur kryesisht nga segmenti MTPL, i cili kapi shifrën prej 1.84 miliardë euro.

Siguruesit polakë paguan rreth 6.26 miliardë euro kompensime dhe përfitime ndaj personave të aksidentuar apo klientëve të tjerë, rreth 2.6% më shumë se një vit më parë. Kushtet e këqija të motit çuan në një rritje të dëmeve të paguara për fermerët si rezultat i dëmtimit të produkteve bujqësore, kështu që dëmet e paguara për klasën “dëmtime të tjera në pronë” u rritën me 74%.

Serbi

<http://www.publicnow.com/view/457CCBE274CE7DCC0638E54DC6A0D71F4F2235A1?2016-12-20-13:30:44+00:00-xxx880>

Banka Kombëtare e Serbisë (NBS) nënshkruan një marrëveshje mirëkuptimi me Mbikëqyrësin e Sigurimeve të Italisë

Duke vlerësuar faktin se Italia është një nga vendet investitore më të rëndësishëm në sektorin serb të sigurimeve, dhe duke synuar për të forcuar më tej sektorin e sigurimeve në Serbi, Banka Kombëtare e Serbisë (NBS) nënshkroi një Marrëveshje Mirëkuptimi me Autoritetin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Italisë (*Italian Insurance Supervisory Authority, IVASS*). Marrëveshja e nënshkruar rregullon veprime të përbashkëta lidhur me shkëmbimin e informacionit midis dy organizmave mbikëqyrës sidomos në lidhje me anëtarët e grupit të biznesit “Unipol” dhe “Generali”, dy nga tre grupet më të mëdha të sigurimeve në Serbi.

Banka Kombëtare e Serbisë ka marrëveshje të tilla mirëkuptimi me Austrinë dhe Slloveninë, të cilat janë vendet me investimet më të mëdha në sektorin e sigurimeve në Serbi.

amf ALBANIA

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al